



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TEPELENË

KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1756 Prot.

Tepelenë, më 01 . 10 . 2025

VENDIM

Nr. 60 , Datë 30 . 09 2025

PËR

**“ MIRATIMIN NË PARIM TË IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT ME TITULL  
“ARIADNE” NË KUADËR TË INSTRUMENTIT TË PARA ANTARËSIMIT, IPA III,  
PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR GREQI-SHQIPËRI 2021-2027”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 28, pika 1, nenit 54, shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, “, nenit 32, të Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM nr.450 datë 26.07.2018 “Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integrimit evropian, ndërmjet qeverisjes qendrore dhe njësisë të vetëqeverisjes vendore” pika 1 dhe 2 gërma ( b) dhe (d) Koordinimi i programeve të asistencës së Bashkimit Evropian në nivel vendor dhe projekteve ku përfiton Bashkia, në lidhje me aplikimin në projektin me titull “**ARIADNE**”, në kuadër të Programit Ndërkufitar Greqi-Republika e Shqipërisë nën Instrumentin e Asistencës së Paraantarësimit (IPA III) 2021-2027, Ekzekutivi i Bashkisë Tepelenë,

VENDOSI:

1. Miratimin në parim për implementimin e projektit me titull “ARIADNE”, në kuadër të instrumentit të para antarësimit, IPA III, financiar nga Programi i bashkëpunimit Ndërkufitar Greqi -Republika e Shqipërisë, 2021-2027.
2. Bashkia Tepelenë, si partner në këtë projekt, bazuar në kushtet dhe kriteret e aplikimit në projekte IPA, të marrë përsipër mbulimin e kostos së bashkëfinancimit të projektit dhe TVSH-së bazuar në buxhetin e palës shqiptare dhe përfshirjen e kësaj kostoje dhe TVSH-së në buxhet. Sipas Buxhetit Afatmesëm 2026 – 2028, buxheti për Bashkinë Tepelenë është **128,478.72 euro** nga të cilat: **108.081.92 euro** Kontribut i BE dhe **20.396,80 euro** bashkëfinancim i Bashkisë Tepelenë.



3. Për zbatim të këtij vendimi, ngarkohet Ekzekutivi i Bashkisë Tepelenë, të ndjekë të gjitha hapat e duhura për ecurinë e projektit.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Arben Gumeni**



**SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

Valbona Çela

Miratuar me: 11 vota

Vota Pro: 11

Vota Kundër: 0

Vota Abstenim: 0

Zbardhur më datë: 01.10 2025